

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E IX-TË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË,  
MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2014**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën **13:37**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Agron Perquku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhalii, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Syzana Sylja, anëtare e kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Para se të fillonte debati për rendin e ditës, e dha betimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Agron Perquku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - propozoi që në “të ndryshme” të futet edhe shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - propozoi që në “të ndryshme” të futen propozimet nga LDK-ja për dy komitetet obligative.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika nr. 8 Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, pasi që disa mbledhje të kuvendit më parë jemi pajtuar që në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti të procedohet heqja e taksës në firmë, në mënyrë që bizneseve t’iu krijohen lehtësira dhe investitorëve potencialë për të investuar në Komunën e Vushtrrisë. Në fund kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të KK-së të përgatitet propozim-vendimi për heqjen e taksës në firmë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - paraqiti shqetësimin e qytetarëve, pasi që nga reshjet e fundit është prishur rruga Gllavotin-Beçuk, e cila në çdo moment paraqet rrezik potencial për humbjen e jetës së ndonjë qytetari, prandaj kërkoi që të ndërmerren masa urgjente për rregullimin e rrugës në fjalë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - paraqiti shqetësimin lidhur me numërimin e votave të anëtarëve të kuvendit, pasi që shumë herë nuk po dihet sesi po votojnë anëtarët e kuvendit, sepse disa prej tyre shpesh nuk i ngritin duart, prandaj për të ardhmen kërkoi që të dihet saktë sa votojnë “për”, sa “kundër” dhe sa po “abstenojnë”. Pastaj paraqiti vërejtje për kryesuesin e kuvendit, pasi që në mbledhjen e parafundit të kuvendit, në pikën “të ndryshme” ishte duke e bërë konceptin për diskutim, kurse kryesuesi i kuvendit e shpalli të mbyllur mbledhjen në fjalë, prandaj kërkoi që në të ardhmen mbledhja të mos ngutet.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime, miratoi këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2015.
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 (shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.153/14, dt.17.07.2014 për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2014.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestininimin e mjeteve buxhetore të komunës.
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për pagesën e mjeteve për sigurim fizik të objekteve shkollore nga të hyrat vetanake prej kategorisë mallra dhe shërbime.
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2013/2014, dhe përgatitjet për vitin shkollor 2014/2015.
9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
10. Të ndryshme:
  - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës.
  - b. Shqyrtimi i Propozimeve nga LDK-ja për dy komitetet obligative.
  - c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

### 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

**Selvete Sholla, anëtare e kuvendit** - tha se në faqen nr. 6 diskutimi i saj nuk është paraqitur në emrin e saj, prandaj kërkoi nga sekretaria që të korrigjohet ky gabim teknik.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** - kërkoi që të korrigjohet diskutimi i saj dhe ta ketë këtë përmbajtje: “propozoi që për nxënësit me aftësi të kufizuara të angazhohet një mësimdhënës i veçantë apo asistente krahas mësimdhënësit, duke pasur bashkëpunim të ngushtë mes vete”.

*Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, me vërejtjet nga S.Sholla dhe H.Gërxhaliu.*

## 2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në këtë raport është prezantuar vetëm implementimi i planeve investuese të komunës, kurse nuk flitet për situatën ekonomiko-financiare, duke shtuar se situata ekonomiko-financiare nuk nënkupton vetëm një tabelë, por raporti duhet të përfshijë edhe shumë segmente të raportit, prandaj raporti si i tillë është i mangët edhe për shumë informata të tjera, të cilat janë kategori përcaktuese dhe matëse të situatës ekonomiko-financiare të komunës sonë. Pastaj tha se në këtë raport nuk ka asnjë fjalë për situatën ekonomike, dhe kjo vjen si pasojë e mungesës së ekspertizës profesionale të komunës, prandaj pyeti cila është sot pozita ekonomike e Vushtrrisë karshi nevojave që ka. Mandej pyeti se përveç administratës komunale, cilat burime të tjera financiare kanë operuar në Komunën e Vushtrrisë; cilat janë investimet e huaja direkte për këtë gjashtëmujor; cilat dhe sa janë aksionet e investuara të të huajve (diasporës dhe të qytetarëve të komunave tjera) në kompanitë që operojnë në Komunën e Vushtrrisë; cilat janë eksportet e ekonomisë së Vushtrrisë në këtë periudhë raportuese; cili është niveli i remitencave në këtë gjashtëmujor, a ka pasur debat për këto çështje në nivel të komunës, të organizuar nga komuna me biznese, shoqata dhe asociacione të tyre; cilat janë resurset e mundshme turistike në komunën tonë, a ka ndonjë publikim që do të mund t'i referohemi; cili është niveli pjesëmarrës në bruto-prodhimin vendor nga Vushtrria, burimet alternative të përmirësimit të situatës ekonomiko-financiare, prandaj këto janë disa nga çështjet që është dashtë të trajtohen në këtë raport dhe për të cilat çështje kërkohet zgjidhje konkrete. Në fund tha se raporti në fjalë ka të meta edhe te Qendra për Punë Sociale ku thuhet se asistencë sociale marrin gjithsej 1557 shfrytëzues, e që në fakt këto janë familje, pastaj është shifër e gabuar numri i kërkesave të reja, pasi që në vend të numrit 163 duhet të jetë 150 familje, e jo shfrytëzues, kështu që është dashtë të cekën kategoritë dhe të përmenden shfrytëzuesit për secilën kategori.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se raporti në fjalë është përgatitur në mënyrë profesionale dhe i njëjti nuk është ekspertizë financiare, prandaj përmbajtja e raportit është konform asaj që kërkohet të përmbajë një raport. Në fund në emër të Grupit kuvendar të PDK-së e përgëzoi kryetarin e komunës dhe qeverinë lokale për përgatitjen e raportit në fjalë.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - lidhur me raportin në fjalë, tha se te faqja nr. 11 në dy vende ceket “ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit”, prandaj kërkoi sqarim se në cilat lokalitete është bërë ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit. Pastaj kërkoi që të precizohen se ku janë realizuar edhe këto projekte: ndërtimi i urave; vendosja e kamerave; çka është renovimi në stacionin e autobusëve; rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave. Mandej tha se është një gabim pasi që në faqen 12 dhe 16 figuron dy herë ngritja e serrave, pemishteve dhe bletoreve me shuma të ndryshme, prandaj kërkoi sqarime. Në vazhdim në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi listën e atyre të cilëve iu janë dhënë serra, fidane për pemishte dhe bletë. Te faqja nr. 16 “tek pyllëzimet” pyeti se a nuk ka pasur mjete apo nuk ka pasur vullnet për pyllëzime, pasi që komuna jonë ka mjaft nevojë të për pyllëzim; te faqja nr. 26 tha se në tre muajt e parë të vitit janë shpenzuar karburante shumë më pak sesa në tre muajt e dytë të vitit, prandaj kërkoi sqarim pse ka shpenzim të karburanteve dukshëm më shumë në tre muajt e dytë të vitit, duke pyetur se a mos janë shfrytëzuar karburantet edhe për fushatën zgjedhore; në faqe 30 “te shëndetësia” thuhet se vetëm 20 % të pacientëve kanë participuar, dhe sqaroi se kjo gjendje ekziston pasi që janë dhënë librezat sociale pa kriter, duke shtuar se në asnjë shtet kapitalist nuk ka shëndetësi pa pagesë, prandaj kërkoi që në të ardhmen të mos lëshohen librezat pa kriter. Kurse lidhur me listën e donacioneve të paraqitura në faqen nr. 31 dhe 32, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi listën e përfituesve, si dhe të sqarohet se a

sjellin raporte me shkrim për destinimin e këtyre mjeteve. Po ashtu kërkoi listën me emra dhe mbiemra të përfituesve dhe shumën e shpenzuar të ndihmës momentale në mbështetje financiare nga buxheti komunal që kanë përfituar 149 familje, si dhe për përfituesit e veshmbathjeve; mjeteve financiare në vlerë prej 30 € për 110 familje; pakove ushqimore për 200 familje; mish viçi për 100 familje. Në fund në faqe 33 tha se është cekur se te situatat emergjente janë shpenzuar 2.695 €, prandaj kërkoi që në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi sqarime se çfarë punë janë kryer në këtë situatë emergjente, po ashtu pyeti se a janë ndihmuar bujqit që kanë pësuar nga vërshimet, ku më së shumti kanë pësuar bujqit nga fshati Pestovë dhe Dobërllukë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - paraqiti sqarime shtesë lidhur me raportin në fjalë, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë është ndër komunat e para që ka shpenzuar më së miri buxhetin e planifikuar për periudhën gjashtëmujore. Në fund iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me këtë raport.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - lidhur me asistencën sociale, apeloj që zyrtarët përkatës të mos luajnë me atë kategori, duke shtuar se ka raste kur po largohen (hiqen) nga lista e përfituesve të asistencës sociale pa paralajmërim, prandaj kërkoi që rastet e tilla të trajtohen në mënyrë meritore dhe më njerëzore.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - duke iu referuar shqetësimit të ngritur nga M.Ferizi për rastet sociale, tha se detyrë e kryetarit të komunës është që në çdo segment (në çdo drejtori) të punohet në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi dhe shtoi se trajtimin e rasteve sociale e ka në kompetencë komisioni i veçantë nga niveli qendror.

### **3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e buxhetit dhe projekteve investuese për vitin 2015.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se angazhimi ka qenë i madh nga të gjithë akterët kompetentë për hartimin e një draft-buxheti sa më të mirë, duke u bazuar në tri komponente kryesore: aftësia investive financiare që ka komuna; prioritetet investive janë të radhitura dhe pasqyruara në tabelën nr. 4.2 (e cila është pjesë përbërëse e propozim-vendimit në fjalë); janë respektuar me korrektësi identifikimet e projekteve buxhetore, duke iu dhënë prioritet propozimeve që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore me qytetarë.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin në fjalë, pyeti se a do të respektohen procedurat e shqyrtimit publik deri në këshillat e fshatrave dhe shtoi se kanë vërejtje tek struktura e burimit të mjeteve buxhetore, por edhe tek struktura shpërndarëse, përderisa granti i qeverisë participon me 88.54 %, të hyrat vetanake komunale marrin pjesë në strukturë vetëm me 11.46 %, dhe nga kjo mund të konstatohet se komuna është në gjendje t'i kryejë detyrimet e veta nga nevojave buxhetore me vetëm 11 %. Pastaj tha se Grupi kuvendar i LDK-së ka vlerësuar burimet vetanake të financimit të aktiviteteve komunale të shprehura në përqindje prej 15.14 %, po ashtu kemi vlerësuar në rritje të hyrash vetanake të shprehura në përqindje prej 32.26 % rritje e të hyrave vetanake nga burimet disponibël komunale. Në vazhdim tha se Grupi kuvendar i LDK-së ka paraparë që fondi për shpenzime, mallra dhe shërbime të zvogëlohet për 583.000 € dhe kjo vlerë t'ju rritet subvencioneve në bujqësi, pasi që është tejet e nevojshme për stadin e zhvillimit të cilën e ka komuna. Mandej tha se komuna ka për obligim që resurset e veta financiare t'ia adresojë nevojave për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, prandaj me draft-buxhetin në fjalë kjo nuk do të ndodh, dhe për këtë arsye propozoi që shpenzimet kapitale të riorientohen në transferimin nga buxheti konsumues në buxhet të investimit të zhvillimit të drejtpërdrejt ekonomik; buxheti për investime kapitale nuk guxon të jetë në shërbim të përmbushjes të premtimeve joracionale zhvillimore, por ato duhet të shndërrohen në kategori që hapin perspektivën e zhvillimit të ekonomisë komunale; komuna është dashur të bëjë një analizë se

cilat investime kapitale hapin shtigjet e zhvillimit ekonomik. Në fund në emër të Grupit kuvendar të LDK-së paraqiti propozimet konkrete për projektet kapitale: te faqja nr.6 te projekti “vazhdimi i asfaltimit të rrugës “Hamdi Gashi” t’i shtohet edhe rregullimi i shtratit të lumit “Podrançe”; te faqja nr.7 të përfshihet renvonimi i ish-shkollës së mesme teknike.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se mungojnë këto investime: ndërtimi i një çerdheje publike në qytet, pasi që qyteti i Vushtrrisë e ka vetëm një të tillë, e që është e pamjaftueshme; kontrollim mjekësor të rregullt për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe sigurimi i një shujte në ditë për të gjithë nxënësit deri në klasën e V-të; mbështetje financiare në formë të bursave për studentët në drejtimet deficitare; fillimi i pajisjes së shkollave me mjete të konkretizimit, përfshirë edhe krijimin e bibliotekave dhe sallave të leximit; krijimi i një pike grumbulluese dhe i një depoje për ruajtjen e prodhimeve bujqësore; subvencionimi i vendosjes dhe zgjerimit të serrave; ofrimi i këshillave profesionale për fermerët lokal për planifikimin dhe orientimin në prodhim; restaurimi i fushës sportive të “Parku i qytetit”, pasi që për momentin shfrytëzohet si parking i mjeteve të rënda nga kompania “Rukolli”, e cila është e afërt me pushtetin; vendosja e shportave për hedhjen e mbeturinave të imëta; mbështetja e klubeve lokale sportive dhe promovimi i sportit në të gjitha nivelet, përfshirë edhe shkollat; përkrahja e shoqatave dhe organizatave që merren me përkujdesjen e njerëzve me nevojave të veçanta dhe kategorive që kanë nevojë për përkujdesje sociale, duke vënë fokusin tek kategoritë e dala nga lufta; ndarja e një fondi të veçantë për sigurimin e ushqimit dhe të veshmbathjes për familjet me kushte të rënda sociale; eliminimi i deponive të egra të mbeturinave në fshatrat e Komunës së Vushtrrisë (siç është edhe rasti i fshatit Sumë). Në fund tha se duke parë se orientimi i qeverisjes aktuale nuk dallon fare nga ajo e vitit të kaluar, e cila është përqendruar në asfalt, zhavorr, beton dhe hekur, ku është më i mundshëm klientelizmi dhe përfitimi përmes tenderëve, dhe mbetet tejet shqetësuese lënia anash e sektorëve si: kujdesi social, arsimit, bujqësia, shëndetësia, kultura, mjedisi dhe turizmi, prandaj Grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje kundërshtojmë draft-buxhetin për vitin 2015 dhe do të votojmë kundër.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** - duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tek asfaltimi i rrugëve në Studime, propozoi të hyjë edhe lagjja “Sfarça”, e cila gjendet në periferi të qytetit. Në vazhdim paraqiti një rezymë lidhur me funksionimin e Grupit të grave deputete, si dhe propozoi që për Grupin e grave në fjalë të ndahet shuma prej 10.000 € për realizimin e aktiviteteve të shumta.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tek tabela 4.2 pyeti ku mendohet të ndërtohen parkingjet, rrugët me kubëza betoni, ndërtimi i trotuareve, ndërtimi i kanalizimeve, rregullimi i lumenjve dhe bademeve. Pastaj lidhur me rrugën e vjetër në fshatin Dobërllukë, propozoi që të ndërtohet rruga në fjalë, e cila njihet si rruga e “Xhaferëve” e cila është rrugë lidhëse e të gjitha arave të këtij fshati, si dhe propozoi që për të ardhmen të planifikohet ndërtimi i urës në këtë lokacion. Në vazhdim tha se nëse inkorporohen në këtë draft-buxhet propozimet nga Grupi kuvendar i LDK-së, atëherë do ta votojmë draft-buxhetin në fjalë. Në fund pyeti se në cilin lokalitet është paraparë ndërtimi i QMF-së? Po ashtu tha se për renovimin e Palestrës sportive, shuma prej 15.000 € është e vogël, si dhe pyeti se për çfarë rrethoje është menduar për oborrin e Kalasë.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tek asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik, propozoi që t’i jepet prioritet asfaltimit të lagjes “Makiqi” te shkolla, në vend të lagjes “Makiqi” te xhamia, por nëse ka mjete të asfaltohen të dyja lagjet. Kurse lidhur me asfaltimin e rrugëve lokale në fshatin Novolan, tha se e ka marrë edhe premtimin nga kryetari i komunës se rruga e parë që do të asfaltohet do të jetë rruga e vjetër e “Oblevikut” që lidhet me rrugën e Skënderajt.

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tek subvencionet, shprehu shqetësimin e tij për mosplanifikimin e mjeteve të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, edhe pse në disa Komuna të

Kosovës është duke u praktikuar, prandaj kërkoi që në planifikimet e ardhshme buxhetore të parashihen edhe këto shpenzime.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tha se përveç këtij dokumenti, kuvendi i komunës ka miratuar paraprakisht edhe një dokument tjetër për zhvillimin e komunës për periudhën kohore 2013 – 2018, duke shtuar se ka mospërputhje të disa shifrave në mes të Strategjisë për zhvillimin ekonomik dhe draft-buxhetit në fjalë, prandaj kërkoi që të harmonizohen mes vete këto shifra. Në fund propozoi që të ndahen mjete financiare (një sasi e mjeteve nga Drejtoria për Arsim dhe nga Drejtoria për Shëndetësi) që për vitin vijues të realizohet projekti për kontrollimin sistematik shëndetësor të nxënësve të shkollave të Komunës së Vushtrrisë.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin, tek subvencionet, propozoi që t'i ndahen subvencione edhe shoqatës humanitare “Çeshme” për t’ua mundësuar pjesëmarrjen nëpër turnire dhe festivale ndërkombëtare. Po ashtu e mbështeti propozimin e E. Lahut që të planifikohen shpenzimet për heqjen e shpenzimeve për ceremoninë e varrimit, sidomos për rastet sociale.

**Shaban Beka, anëtar i kuvendit** - lidhur me draft-buxhetin në fjalë, tek asfaltimi i rrugëve lokale në Novolan, pyeti se a është e përfshirë edhe lagjja “Ferizi”, që është pjesë e fshatit Brusnik, dhe e njëjta lagje është propozuar për asfaltim nga pjesëmarrësit gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore. Po ashtu propozoi që rruga e vjetër e fshatit Duboc të lidhet me rrugën e shkollës kah lagjja “Kovaçi”.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - duke iu referuar draft-buxhetit në fjalë, tha se planifikimit të këtij draft-buxheti i ka paraprirë një angazhim sistematik që nga muaji qershor, duke shtuar se KPF-ja së bashku me kryetarin e komunës dhe qeverinë lokale e kanë hartuar një plan veprimi, duke organizuar takime për dëgjime buxhetore në secilën bashkësi lokale. Po ashtu tha se përmes planifikimit janë përfshirë të gjitha bashkësitë lokale, duke shtuar se asnjë bashkësi lokale nuk ka mbetur e papërfshirë sidomos në investime kapitale. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-buxhetin në fjalë, si dhe iu përgjigj pyetjeve, propozimeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me këtë draft-buxhet. Po ashtu propozoi që nga subvencionet e kulturës të ndahet shuma prej 5.000 € për Grupin e grave deputete. Në fund tha se në vend të participimit të qytetarëve për realizimin e projekteve, propozoi që të merret vendim i ri nga kuvendi i komunës ku do të kenë prioritet të realizimit të ndonjë projekti ata që kanë paguar obligimet e tatimit në pronë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 9 “kundër” vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2015, konform Qarkores Buxhetore 2015/02 të MEF-it, dt. 08.08.2014.*

*Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2015 është 14,625,419 €, prej të cilave për:*

- Paga.....9,110,000 €.
- Mallra dhe shërbime.....1,381,830 €.
- Komunalitë.....222,242 €.
- Subvencione.....222,500 €.
- Shpenzime kapitale.....3,688,847 €.
- Githsejt:.....14,625,419 €.

#### **4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 (shqyrtimi i dytë).**

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se bazuar në nenin 6.4. të Ligjit për kategoritë e dala nga lufta i liron nga pagesa e tatimit në pronë këto kategori: familjet e dëshmorëve, invalidët e UÇK-së, invalidët civil të luftës, familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike, prandaj propozoi që paragrafi në fjalë të përfshihet në këtë draft-rregullore.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë, duke shtuar se draft-rregullorja në fjalë është në harmoni të plotë me Ligjin për Tatimin në Pronë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se tatimi në pronë është burimi kryesor i të hyrave vetanake të komunës. Pastaj për vitin e ardhshëm propozoi që të bëhet rregullimi ndryshe i ngarkesave, duke shtuar se ngarkesa do të ishte më e drejtë nëse veprohet në bazë të zonave sipas planit urban të qytetit, pasi që gjendja aktuale nuk paraqet ngarkesë reale për obliguesit tatimor, pasi që zona e parë ka çmim vlerësues të njëjtë sikur në qendër të qytetit ashtu edhe në periferi të qytetit. Në vazhdim kërkoi që drejtoria kompetente të krijojë partneritet me tatimpaguesit e tatimit në pronë, duke i informuar me kohë për çështjet lidhur me rëndësinë e pagesës së tatimit në pronë. Po ashtu kërkoi që drejtoria kompetente të bëjë shtrirjen e bazës së regjistrimit të pronave, pasi që gjendja aktuale në terren nuk përputhet me gjendjen faktike të objekteve, duke propozuar që të bëhet një plan veprimi për të identifikuar dallimet e tilla, dhe për të vendosur kritere të barabarta për të gjithë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, 3 “abstenim” vendosi me sa vijon:**

*Aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015.*

#### **5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.153/14, dt.17.07.2014 për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2014.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

*Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi 01Nr.153/14, dt. 17.07.2014 për ndryshimin dhe harmonizimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2014.*

#### **6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që shuma totale duhet të figurojë në këtë propozim-vendim.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, te tabela 4.2 rubrika “inventari i shkollës fillore në Pestovë” kërkoi që të hiqet nga tabela, pasi që Ministria e Arsimit e ka furnizuar këtë shkollë me inventar, prandaj propozoi që të riemërtohet “inventarizimi i shkollave të Komunës së Vushtrrisë”.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së** - lidhur me vërejtjen e Q.Selimit, sqaroi se nuk ka ndonjë gabim në atë rubrikë, por këto mjete destinohen për një çështje tjetër edhe pse formulimi ka mbetur në atë mënyrë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

*Me këtë Vendim bëhet ridestinimi i mjeteve nga fondi 10(Grandi Qeveritar) dhe fondi 21 (Të Hyrat Vetanake) nga kategoria e investimeve kapitale, sipas tabelës 4.2, kodi i programit 644175,Buxhet dhe Financa, kodi i programit 644180, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia, kodi i programit 644660-Plnifikimi Urban dhe Mjedis),nga këto projekte, kodi i programit 644730, Shëndetësia Mirëqenia Sociale, kodi i programit 644920-Arsim dhe Shkencë.*

*Nga projektet e cekura ridestinohen mjetet në vlerë prej 117,081.43 € sipas tabelës 4.2, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.*

**7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për pagesën e mjeteve për sigurim fizik të objekteve shkollore nga të hyrat vetanake prej kategorisë mallra dhe shërbime.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

*Me këtë Vendim të bëhet pagesa e sigurimit fizik të objekteve shkollore nga (të hyrat vetanake) fondi 21 nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve nga këto programe buxhetore:*

*Zyra e Kryetarit, Kodi i programit/nënprogramit 16024, shuma e mjeteve 15,000.00 €;*

*Drejtoria për Inspektime, Kodi i programit/nënprogramit 166, shuma e mjeteve 8,000.00 €;*

*Drejtoria për Prokurim Publik, Kodi i programit/nënprogramit 167, shuma e mjeteve 2,000.00 €;*

*Zjarrfikësit, Kodi i programit/nënprogramit 18024, shuma e mjeteve 15,000.00 €;*

*Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronës, Kodi i programit/nënprogramit 65120, shuma e mjeteve 2,000.00 €;*

*Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kodi i programit/nënprogramit 66425, shuma e mjeteve 2,000.00 €;*

*Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Kodi i programit/nënprogramit 85024, shuma e mjeteve 2,000.00 €.*

**8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2013/2014, dhe përgatitjet për vitin shkollor 2014/2015.**

**Selvete Sholla, anëtare e kuvendit** - tha se informata në fjalë është e kompletuar. Pastaj tha se nga informata në fjalë kuptohet se në testin e maturës ka ndryshim shumë të madh, sidomos në shkollën e mesme profesionale, ndërsa në shkollën e mesme “Lutfi Musiqi” nuk e kalon 50 %-shin. Në fund kërkoi për të dytën herë me radhë që të bëhet ndriçimi i rrugës në hyrje të të dy shkollave (teknike dhe profesionale), duke shtuar se nëse nuk ka mjete financiare Drejtoria për Arsim, atëherë kërkoi që ndriçimin e kësaj rruge ta bëjë Drejtoria për Shërbime Publike.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se informata në fjalë i ka të gjitha elementet e nevojshme. Pastaj pyeti se shkolla e muzikës a është në kuadër të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Vushtrrisë apo të Mitrovicës? Po ashtu pyeti se a ka raste që në disa shkolla paguhen e në disa të tjera nuk paguhen edukatorët e parashkollorëve, si dhe propozoi që në të ardhmen të hapen klasë për parashkollorë në të gjitha shkollat dhe të paguhen të gjithë mësimmshënësit e parashkollorëve.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së** - sqaroi se të gjitha të dhënat e paraqitura në informatën në fjalë janë si rezultat i kërkesave dhe propozimeve nga anëtarët e KPF-së. Pastaj sqaroi se Drejtoria për Arsim iu mundëson hapësirën e objekteve shkollore për organizimin e mësimit



për parashkollorët të gjitha shkollave, kurse mundësitë financiare të Drejtorisë për Arsim janë të kufizuara dhe aktualisht bën pagesën e tri edukatoreve në tri shkolla të qytetit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - njoftoi se shefe e Grupit kuvendar të LDK-së është emëruar Fatime Haziri.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi informatë në rastin konkursit në shkollën e mesme "Bahri Haxha" lidhur me emërimin e zëvendësdrejtorit.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së** - duke iu referuar pyetjes së F.Haziri, sqaroi se që nga muaji shkurt i këtij viti, Drejtoria për Arsim, ka obligim që të gjithë udhëheqësit e shkollave (drejtorët dhe zëvendësdrejtorët) që t'i sistemojë nëpër vende adekuate të punës, prandaj në pamundësi që të sistemohet në vendin adekuat të punës zëvendësdrejtori i kësaj shkolle, Drejtoria e Arsimit ka bërë emërimin e tij të përkohshëm (deri në një zgjidhje tjetër) në pozitën e zëvendësdrejtorit.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit** - pyeti se sa është në gjendje Drejtoria për Arsim, gjegjësisht komuna t'i plotësojë obligimet që dalin nga kontrata kolektive?

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së** - lidhur me pyetjen e B. Pllanës u përgjigj se deri në janar të vitit 2015 kontrata kolektive nuk ka implikime buxhetore dhe nënshkrues i kësaj kontrata është Qeveria e Republikës së Kosovës.

## **9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se informata në fjalë është sipërfaqësore, selektive në përmbajtje, dhe si e tillë ofron një situatë të zbehur në terren, pasi që mungojnë detaje të rëndësishme që do të paraqisnin një pasqyrë reale të rendimenteve, dhe se në cilat zona cila kulturë i ka pasur rendimentet e nivelit më të lartë, e në cilat nivel më të ulët. Po ashtu informata në fjalë nuk jep detaje rreth mbarëvajtjes së procesit të korrje-shirjeve, nuk dihet gjendja teknike e autokombajnave, prandaj kërkoi që drejtoria kompetente në të ardhmen t'i ketë parasysh që edhe këto elemente, t'i inkorporojë në informatat që ia paraqet kuvendit të komunës.

## **10. Të ndryshme:**

### **a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës.**

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** - paraqiti disa alternativa lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - propozoi që lokacioni për ndërtimin e objektit në fjalë të jetë fshati Bukosh.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se lokacioni i paraqitur në propozim-vendimin në fjalë nuk është i qëlluar, pasi që në atë lokacion në fshatin Sumë janë bërë shumë luftëra dhe i njëjti lokacion ka një histori të lavdishme, ku ka qenë edhe Kulla e Adem Vocës, prandaj kërkoi që të ndërrohet lokacioni për ndërtimin e objektit në fjalë, sepse në lokacionin në fjalë banorët e fshatit Sumë kanë propozuar ndërtimin e një kulle apo të një qendre memoriale.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit në fjalë propozoi fshatin Gllavotin ose fshatin Mihaliq.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - propozoi që lokacioni në fjalë të jetë sa më afër qytetit, për të mos krijuar shpenzime më të mëdha. Gjithashtu njoftoi se pas dy viteve objekti në fjalë mund t'i mbetet në shfrytëzim kompanisë për menaxhimin e mbeturinave.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - tha se rrugës për në fshatin Pasomë ka filluar ndërtimi i një objekti për të shërbyer si depo e mbeturinave, prandaj pyeti se a është depo për grumbullimin e mbeturinave të vrazhda. Po ashtu kërkoi që të definohet se hapësira ku po hidhen mbeturinat a është depo për këtë qëllim, si dhe propozoi që nëse është deponi e mbeturinave, atëherë t'i jepet dikujt nën menaxhim. Në fund propozoi që hapësira në fjalë të caktohet si lokacion për ndërtimin e objektit në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për grumbullimin, selektimin dhe paketimin e letrës dhe plastikës në pjesë të parcelës kadastrale P-70202010-00210-0, në sipërfaqe prej 01.00.00 ha, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2.51.93 ha, e cila gjendet në Zonën Kadastrale Bukosh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.*

#### **b. Shqyrtimi i Propozimeve nga LDK-ja për dy komitetet obligative.**

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - kërkoi që subjektet politike të përfaqësuara në komitetet obligative, të respektojnë 30 %-shin e përfaqësimit gjinor në komitetet obligative në përputhje me Udhëzimin Administrativ për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së paraqiti këto propozime: Fatime Hazirin për anëtare të KPF-së, kurse Agron Perqukun për anëtar të Komitetit për Komunitete.

**Lidhur me propozimin për anëtare të KPF-së, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.22/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të KPF-së me sa vijon:*

*Emërohet anëtare e KPF-së Fatime Haziri në vend të Ismet Gashit.*

**Lidhur me propozimin për anëtar të Komitetit për Komunitete, Kuvendi pas votimit me 11 vota “për”, 12 “kundër” vendosi me sa vijon:**

**Nuk aprovohet propozimi që Agron Perquku të bëhet anëtar i Komitetit për Komunitete.**

#### **c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të vendoset ndriçimi publik prej “Kosova Petrolit” e deri te xhamia. Pastaj pyeti se a mund të ndihmohet financiarisht nga Drejtoria për Kulturë botimi i librave të autorit Ferit Dibrani. Mandej tha se në ditët e fundit është shfaqur një sëmundje e deleve në disa komuna, prandaj pyeti se si qëndron çështja në Komunën e Vushtrrisë, si dhe a ka ndër marrë diçka në këtë drejtim Drejtoria për Bujqësi. Në fund ngriti çështjen e mbeturinave të ngurta, të cilat po hedhen përgjatë rrugës Banjskë-Pasomë, kështu që kërkoi që të merren masa për largimin e atyre mbeturinave.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që ngastra kadastrale në të cilën gjendej objekti i ndërmarrjes së ashtuquajtur “zhito-promet”, e cila gjendet përballë Shkollës së Policisë, të bëhet përkufizimi i saj dhe e njëjta të procedohet për dhënie në shfrytëzim.


**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** - kërkoi që në Zyrën për Komunitete dhe Kthim, të punësohet një përfaqësues nga komuniteti turk. Po ashtu në emër të komunitetit turk kërkoi nga Drejtoria e Administratës që në Zyrën e Gjendjes Civile të punësohet një apo dy zyrtarë

që e njohin gjuhën turke, në mënyrë që dokumentet e gjendjes civile sipas kërkesës së palëve të lëshohen edhe në gjuhën turke.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës** - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: do të bëjmë përpjekje për ndriçimin publik prej “Kosova Petrolit” e deri te xhamia; kryetari i komunës nuk ka të drejtë të nënshkruajë subvencione në vlerë më të madhe se 500 €, si dhe njoftoi se brenda kësaj jave i ka ndarë shumën prej 500 € Ferit Dibranit për botimin e një libri; nuk ka informacione deri më tani që sëmundja e deleve ta ketë prekur Komunën e Vushtrrisë; do të angazhohet personalisht për t’i larguar ato mbeturina të ngurta, duke shtuar se duhet gjetur një hapësirë të përshtatshme për të hedhur këto mbeturina; nuk ka hapësirë të madhe në mes të objektit të ashtuquajtur “zhito-promet” dhe rrugës së ndërtuar, duke përkrahur propozimin që në të ardhmen të jepet në shfrytëzim për ndonjë kioskë, edhe pse do të ishte mirë të mendohet që në një hapësirë të ketë gjelbërim, kurse për kërkesat e E. Sungurit, tha se duhet konsultuar me juristët se sa ka mundësi ligjore për t’u implementuar ato kërkesa.

**Mbledhja përfundoi në orën 17:09.**

**Procesmbajtësi**

  
**Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Shpëtim Zhegrova**

